



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

SSH.08 STANDARDET E SIGURIMIT TE BRENDSEHEM TE
CILESISE

SSH.08.01 Standardi i sigurimit te brendshëm te cilësisë

UPT duhet te jete përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe te ngrrejë njësinë përkatëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në te duhet te marre pjesë gjithmonë edhe një përfaqësues nga organizimet studentore të UPT, si dhe një përfaqësues ekspert i jashtëm. Njësia duhet te vlerësoje periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore apo artistike, si dhe të veprimtarive administrative e financiare të UPT. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e UPT.

Kriteret dhe procedurat për ngritjen dhe funksionimin e këtij sistemi duhet te hartohen nga UPT, në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe duhet te përcaktohen në statutin e UPT.

UPT duhet te publikojë rezultatet e vlerësimit që kryen.

SSH.08.02 Standardi Universitar European Nr. 1 i Sigurimit te Cilesise

UPT duhet te kete nje politike dhe procedura te bashkerenduara per sigurimin e cilesise dhe te standardeve te programeve te studimit dhe te diplomave te tyre.

Ai duhet te angazhohet shprehimisht per zhvillimin e nje kulture e cila njuh rendesine e cilesise dhe te sigurimit te cilesise ne punen e tyre. per te arritur kete universiteti duhet te zhvilloje dhe te vere ne jete nje strategji per permiresimin e vazhdueshem te cilesise.

Strategjia, politika dhe procedurat duhet te kene nje status zyrtar dhe te jene te disponueshme publikisht. Ato gjithashtu duhet te perfshijne nje rol per studentet dhe paleve te tjera te interesuara.

SSH.08.03 Standardi Universitar European Nr. 2 i Sigurimit te Cilesise

UPT duhet te kete mekanizmin zyrtar per aprovimin, rivleresimin periodik dhe monitorimin e programeve dhe diplomave te tyre.

SSH.08.04 Standardi Universitar European Nr. 3 i Sigurimit te Cilesise

Studentet duhet te vleresohen duke perdorur kriteret te publikuara, rregulla dhe procedura te cilat aplikohen ne menyre te qendrueshme.

SSH.08.05 Standardi Universitar European Nr. 4 i Sigurimit te Cilesise

UPT duhet te kete menyra per t'u siguruar se stafi i perfshire ne mesimdhenien e studenteve eshte i kualifikuar dhe kompetent.

Ai duhet te jete i disponueshem ndaj atyre qe ndermarrin vleresimet e jashtme dhe ndaj komenteve te raporteve.

SSH.08.06 Standardi Universitar European Nr. 5 i Sigurimit te Cilesise

UPT duhet te sigurohet qe burimet e disponueshme per te mbeshtetur mesimnxenien e studentit, jane te pershtatshem dhe te pershtatur per çdo program studimi te ofruar.

SSH.08.07 Standardi Universitar European Nr. 6 i Sigurimit te Cilesise

UPT duhet te siguroje se ai mbledh, analizon dhe perdor informacion te pershtatshem per administrimin efektiv te programeve te tij te studimit dhe te aktiviteteve te tjera.

SSH.08.08 Standardi Universitar European Nr. 7 i Sigurimit te Cilesise

UPT duhet te publikoje rregullisht informacion te azhurnuar, objektiv dhe te paanshem, si sasijor ashtu dhe cilesor, per programet e studimit dhe diplomat qe ai ofron.